<p>Një ndër prioritetet e Bashkisë Shkodër është zhvillimi i qendrushëm ekonomik dhe përmirësimi i klimës së biznesit në territorin e saj. Për këtë qëllim Bashkia do të vazhdojë të mbështesë iniciativa të reja për zhvillimin e biznesit, në fusha që lidhen me vizionin e zhvillimit të saj. Iniciativa të tilla kanë të bëjnë me krijimin e lehtësirave infrastrukturore të nevojshme për zhvillimin e zonave të reja tregtare si dhe nxitjen e kulturës së sipërmarrjes duke ju përgjigjur zhvillimeve të reja në kohë dhe në mënyrë krijuese. Konkretizimi i ndërhyrjeve në zonat karakteristike të Shkodrës të cilat kanë një potencial të lartë për kthimin e tyre në atraksione turistike dhe integrimi i tyre me ofertën turistike, përfaqësojnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të saj. Trashëgimia dhe kultura identifikohen si elemente të forta territoriale dhe Shkodra është një ndër destinacionet më të rëndësishme në Shqipëri. Prandaj është me shumë interes krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për tërheqjen e investimeve në zonat e përmirësimit të biznesit dhe organizimin e veprimtarive kulturore - artistike në mënyrë që të rrisin numrin e vizitorëve dhe kohën e qëndrimit jo vetëm përgjatë sezonit veror, por gjatë gjithë vitit. Nisma të tilla nuk kanë munguar edhe më përpara, mjafton të përmendim projektin "BID Shkodra" përgjatë rrugëve "13 Dhjetori", "28 Nëntori" dhe "Kolë Idromeno" por është e nevojshme shtrirja e tyre edhe në zona të tjera historike të Shkodrës, ku pa dyshim Shkodrës nuk i mungojnë. Të tilla mbështetje do të ndikojnë në përmirësimin e aksesit ndaj shërbimeve bazë, gjenerimin e të ardhurave dhe krijimin e vendeve të lira të punës.</p>											
ii. Synimi i projektit											
Mbështetja e sa më shumë bizneseve për të konsoliduar dhe rritur aktivitetin e tyre ekonomik, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të zonës së përmirësimit të biznesit, për ta kthyer atë në një vend tërheqës për vizitorin.											
iii. Aktivitetet kryesore të projektit											
<ol style="list-style-type: none"> 1. Identifikimi i zonave gjeografike të caktuara për përmirësimin e bizneseve. 2. Organizimi i tryezave të përbashkëta me bizneset. 3. Themelimi i Zonës së re tregtare. 4. Mbështetja financiare nëpërmjet transferimit të të ardhurave nga tarifat, që mbledhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës. 											
b) Rezultatet që prisni											
Krijimi i Zonës së re të Përmirësimit të Biznesit përgjatë një prej rrugëve karakteristike të Shkodrës. Rritja e cilësisë së shërbimit për vizitorin, të bizneseve që ndodhen përgjatë rrugës së perzgjedhur.											
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt							
Bashkia Shkodër				Bashkia Shkodër							
e) Shpenzimet e llogaritura											
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023					Tot ali (00 0 lekë)	Nga kjo:					
						Pag a	Siguri me	Operati ve	Transferi me	Kapita le	
A.1	Mbështetje nga Bashkia Shkodër për bizneset anëtare të Zonës së re tregtare				1,300			1,300			
Shuma					1,300			1,300			
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024					Tot ali (00 0 lekë)	Nga kjo:					
						Pag a	Siguri me	Operati ve	Transferi me	Kapita le	

A.1	Mbështetje nga Bashkia Shkodër për bizneset anëtare të Zonës së re tregtare	1,300			1,300		
	Shuma	1,300			1,300		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (000 lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Mbështetje nga Bashkia Shkodër për bizneset anëtare të Zonës së re tregtare	1,300			1,300		
	Shuma	1,300			1,300		
f) Periudha e zbatimit 2023, 2024, 2025		g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr.14	P04130.Q1.O3.A9. Mbështetja dhe lehtësimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrim i shkurtër i projektit						
i. Situata						
Bizneset ekzistuese në Shkodër kanë hasur vështirësi për të aplikuar në programet dhe në skemat e ndryshme financiare qeveritare. Kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së informacionit dhe gjithashtu vështirësive që hasin në plotësimin e dokumentacionit ligjor, sipas udhëzimeve të përcaktuara nga ministria e linjës apo edhe nga rregulloret e programeve të ndryshme. Programet mbështetëse dhe instrumentat financiarë qeveritarë janë një mënyrë e mirë për rritjen e konkurrencës në sektorin e bujqësisë dhe industrisë ushqimore, në rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike të zonave malore të disavantazuara, rritjen e ekonomisë lokale nga njëra anë dhe nga ana tjetër përforcimi i marrëdhënieve ekonomike me Bashkimin Europian, mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e transportit të qëndrueshëm dhe të infrastrukturës publike etj.						
ii. Synimi i projektit						
Shtimi i bizneseve që aplikojnë në mënyrë të suksesshme për të përfutur nga programet dhe skemat e ndryshme financiare shtetërore.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ol style="list-style-type: none"> Ofrimi i shërbimeve për dhënie informacioni dhe këshillim; Azhornimi i paketave informuese në lidhje me programet dhe skemat e ndryshme financiare për të cilat mund të jenë të interesuar subjektet e ndryshme; Asistenca për plotësimin e dokumentacionit për aplikim. 						
b) Rezultatet që prisni						
Rritja e numrit të bizneseve që përfitojnë nga programet dhe skemat e ndryshme financiare.						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
Bashkia Shkodër Dhoma e Tregtisë AIDA			Bashkia Shkodër			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali (000 lek)	Nga kjo:			
			Pa ga	Siguri me	Opera tive	Transfe rime Kapit ale
A. 1	Mbështetja dhe lehtësimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare					
	Shuma					
f) Periudha e zbatimit 2023, 2024, 2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr.15	P04130.Q2.O1.A1 Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Tregjet ekzistuese dhe ato të reja që do ndërtohen e kanë të domosdoshme mirëmbajtjen e tyre sepse ato amortizohen. Sot ka tregje pa asnjë mbrojtje nga moti, pa tezgja shitjeje, dhe akses të dobët si për blerësit ashtu edhe për shitësit. Edhe ambientet më të organizuara janë shumë të vogla për të mbuluar fluksin ekzistues të prodhimit. Më shumë duhet të bëhet në drejtim të përmirësimit të ambienteve fizike të tregjeve duke parashikuar riparime në infrastrukture e tezgave, banakeve, lysterje. Mirëmbajtje të hapësirave për automjetet dhe këmbësoret gjithashtu duhen parashikuar mirëmbajtje në banjo publike, eletricitét, uje etj. Riparime në ambjentet e magazinimit të mallit etj.</p> <p>Tarifat kundrejt përdorimit të hapësirave të tregtimit, duhet të përdoren edhe për mbulimin e kostove të mirëmbajtjes.</p> <p>I njejtë model mirëmbajtje duhet të funksionojë pastaj edhe për tregjet e reja që do ndërtohen, në mënyrë që të qëndrojnë përherë brenda standarteve të mira të tregtimit.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<p>Një infrastrukture e përmirësuar e tregjeve do të ndihmonte veçanërisht në përmirësimin e kushteve tregtimit, rritjes së kënaqësisë së blerjes, përmirësim të higjenës dhe reduktimin e mbeturinave.</p>						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ol style="list-style-type: none"> 1. Evidentim i nevojës për mirëmbajtjen e tregjeve; 2. Shërbime të mirëmbajtjes dhe riparime të domosdoshme për ruajtjen dhe qëndrueshmërinë e kushteve të tregtimit; 						
b) Rezultatet që prisni						
Tregje funksionale sipas standarteve dhe që plotësojnë kushtet e tregtimit të lirë						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Bashkia Shkodër F fermerët				Bashkia shkodër		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transf erime Kapitale
A.1	Shërbime të mirëmbajtjes për ruajtjen dhe qëndrueshmërinë e kushteve të tregtimit	700			700	
A.2	Pagesat e shërbimeve me te trete (energji elektrike dhe uje.	300			300	
Shuma		1,000			1,000	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transf erime Kapitale
A.1	Shërbime të mirëmbajtjes për ruajtjen dhe qëndrueshmërinë e kushteve të tregtimit	700			700	
A.2	Pagesat e shërbimeve me te trete (energji elektrike dhe uje.	300			300	
Shuma		1,000			1,000	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transf erime Kapitale

A.1	Shërbime të mirëmbajtjes për ruajtjen dhe qëndrueshmërinë e kushteve të tregtimit	1,000			1,000		
A.2	Pagesat e shërbimeve me te trete (energji elektrike dhe uje.	500			500		
	Shuma	1,500			1,500		
f) Periudha e zbatimit 2023, 2024, 2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit strategjik dhe e përmirësimit të Klimës së biznesit Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve Drejtoria e shërbimeve Publike Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 16	P04130.Q2.O1.A2 Tregu rajonal i peshkut	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Nga vlerësimi i interesit dhe studimi i fizibilitetit për ndërtimin e tregjeve del e domosdoshme ndërtimi i strukturave të reja për tregtim të produkteve të akuakulturës. Tregtaret po shesin prodhimet e akuakulturës në kushte jo të favorshme ndërkohë që në qytetin tone është shtuar me rritme të shpejta konsumimi i peshkut të detit dhe atij të liqenit. Për të përmbushur nevojën konsumatore peshku po kultivohet në rezervate dhe vaska gjithashtu. Në qytet gjenden me dhjetra tregtate që ushtojnë aktivitetin e tyre në kushte aspak të përshtatshme. Ndryshimi në sjelljen konsumatore po sjell nevojën për pajisje magazinimi të rregullta, brenda kushte higjieno-sanitare dhe madje frigoriferike.</p> <p>Të gjitha këto kërkesa kanë sjellë zhvillimin e mëtejshëm të industrisë perpunuese, por për këtë fluks të prodhimeve të akuakulturës duhet të ketë edhe një treg rajonal të mirëmenaxhuar.</p> <p>Teorikisht peshku duhet të shitet sa më afër origjinës së tij. Tregu i peshkut do ishte mirë të kishte një lokacion diku afër liqenit, si burimi kryesor i peshkimit në Shkodër.</p> <p>Bashkia Shkodër duke qënë një zonë bregdetare dhe liqenore njëkohësisht, e ka të domosdoshëm ndërtimin e një tregu rajonal peshku. Një treg sipas standarteve higjieno-sanitare, me tenda, me banakë për tregtimin e peshkut me higjienë. Të këtë dhe kushte frigoriferike për ruajtjen e peshkut të vecantë që nuk vjen gjallë tek ne në treg. Të ndërtohen basene të vegjël për mbajtjen e peshkut që tregtohet i gjallë. Të ketë elektricitet, ujë të pijshëm, sistem të rregullt kanalizimesh për qarkullimin e ujit gjithashtu dhe një vend të vecantë për grumbullimin e mbeturinave. Ku ka nevojë për një pastrim jo vetëm 1 herë në 24 orë, por me shumë. Sidomos gjatë orareve të fluksit të shitjes.</p> <p>Tregu të këne shërbime të domosdoshme, hapësira me mjaftueshmëri për levizjen e automjeteve dhe për parkimin e tyre. Tregu duhet të ketë personel për menaxhim dhe për pastrim e mirëmbajtje. Të ketë zyra për personelin të shoqëruara me shërbime mbështetëse dhe banjo publike.</p> <p>Ndërtimi i tregut rajonal është një proces kompleks që kërkon investime kapitale të konsiderueshme. Ai duhet të mbështetet tek një studim në lidhje me kërkesat e përcaktuara qysh më parë në lidhje me ambientet dhe tek një vlerësim i plotë financiar. Përdoruesit e këtyre ambienteve dhe kushteve për funksionimin e strukturave duhet të përfshihen në procesin e projektimit qysh në fillim. Kjo kërkon konsultime dhe një fushatë ndërgjegjësimit me furnizuesit, transportuesit, tregtaret, punonjësit e tregut dhe autoritetet lokale.</p> <p>Pikërisht në kuadër të ndërhyrjeve të Bashkisë Shkodër për zhvillimin ekonomik duhet bërë planifikim për ndërtimin e tregut rajonal të peshkut për të zhvilluar tregtinë sipas formave të standartizuara. Ndërtimi i tregut rajonal të peshkut ku shërbimi dhe kontrolli nga ana e institucioneve janë me efektive, është një hap i nevojshëm që duhet ndërmarrë në mënyrë që të kemi një integrim dhe standartizim të kësaj ekonomie informale me sistemin ekonomik të bashkisë Shkodër.</p>		

ii. Synimi i projektit						
Ndërtimi i tregut rajonal te peshkut me vende tregtimi te mirëstrukturuar dhe i mirëmenaxhuar.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
Projekti parashikohet të ketë një kohëzgjatje prej 12 muaj. Disa nga aktivitetet më kryesore përfshijnë: 1. Studim fizibiliteti 2. Aktivitete parapërgatitore (Projekti Teknik) 3. Aplikim për Fonde tek FZHR- Granti konkurrues për ndërtim tregjesh agro-ushqimore dhe thertoresh, MBZHRAU 4. Ndërtimi i ambienteve të tregut 5. Ndërtimi i infrastrukturës mbështetëse si rrugë, vende parkimi, energji elektrike, kanalizime etj						
b) Rezultatet që prisni						
Ndërtim i tregut të ri të Peshkut						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)			
Bashkia Shkodër Dhoma e Tregtisë Ministria e Bujqësisë AZHBR			Bashkia Shkodër			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Hartimi i projektit teknik					
A.2	Zbatim i projektit					
A.3	Supervizim					
A.4	Kolaudim					
	Shuma					
f) Periudha e zbatimit 2023, 2024, 2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e planifikimit strategjik dhe përmirësimit të klimës së biznesit Drejtorja e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr.17	P04130.Q2.O1.A3. Tregu i produkteve bujqësore Velipojë	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i. Situata							
<p>Velipoja është një ndër qëndrat më të rëndësishme të turizmit bregdetar, gjithësesi mungojnë tregjet dhe nuk janë në kushte cilësore përsa i përket pastërtisë dhe shërbimeve që ofrohen ndaj qytetarit. Përgjatë sezonit të verës në këtë njësi administrative kemi praninë e shumë vizitorëve dhe turistëve të cilët përveq shërbimeve turistike kanë edhe nevoja për të konsumuar produkte të ndryshme të cilat duhet të tregtohen në ambientet e posaqme. Rrjeti i tregtisë në bashkinë Shkodër duhet të plotësohet me tregjet lokale të shpërndara në njësitë administrative, ku do të promovohet zhvillimi ekonomik lokale veçanërisht në zonat turistike dhe bujqësore si Shkodra (të paktën nga një treg për njësi) dhe Velipoja (2 tregje të cilat do të funksionojnë gjatë periudhës së verës). Tregjet duhet të shihen përtej hapësirës së tregtimit edhe si hapësirë sociale dhe rekreative. Në këto hapësirat rekreative duhet të shërbehen vetëm produkte vendase, pra distanca nga tregu në tavolinë duhet të jetë 0km.</p> <p>Popullsia e përhershme në plazhin e Velipojës është rritur dukshëm duke arritur nga 387 në vitin 1990, në 2 075 banorë në 2016. Në vitin 2005 gjatë periudhës së verës, numri i pushuesve arrinte në 80 000, sipas statistikave gjate vitit arrijnë mesatarisht deri në 100 000 pushues në fundjavat e pikut të sezonit. Duke marrë parasysh sasinë e lartë të produkteve të konsumuara si dhe nevojën për një mjedisi të përshtatshëm për tregtim, nevoja për ndërtimin e tregut është shumë e madhe. Duke qënë një zonë e cila ka edhe karakteristika bujqësore si dhe të shfrytëzimit të akuakulturës dhe peshkimit, impakti i ndërtimit të një tregu me hapsirat e përshtatshme të magazinimit e tregtimit, do të jetë shumë i lartë edhe në zhvillimin ekonomik. Krijimi i tregut formalizuarakushërbimi dhe kontrollingaana e institucioneve është me efektiv, eshtenje hap i nevojshem që duhet ndërmarrë në mënyrë që të këminjë integrim dhe standartizim të ekonomive urale me sistemin ekonomik të bashkisë Shkodër.</p> <p>Ndërtimi i tregjeve të rinj është një proces kompleks që kërkon investime kapitale të konsiderueshme. Ai duhet të mbështetet tek një studim në lidhje me kërkesat e përcaktuara qysh më parë në lidhje me ambientet dhe tek një vlerësim i plote financiar. Përdoruesit e këtyre ambienteve dhe kushteve përfunksionimin e strukturave duhet të përfshihen në procesin e projektimit qysh në fillim. Kjo kërkon konsultime dhe një fushatë ndërgjegjësimi me fermerët, furnizuesit, transportuesit, tregtarët, punonjësit e tregut dhe autoritetet lokale.</p>							
ii. Synimi i projektit							
<p>Formalizimi i tregtimit të shitjes me pakicë në njësinë administrative Velipojë dhe siguri i kushteve të përshtatshme të tregtimit: Mbështetja prodhuesve vendas të bujqësisë, peshkimit dhe akuakulturës, rritja e tregtimit të produkteve si dhe siguria ushqimore.</p>							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ol style="list-style-type: none"> 1. Studim i fizibilitetit të investimit 2. Aktivitete parapërgatitore (Projekti Teknik) 3. Ndërtimi i tregut të shitjes Velipojë 4. Rregullim i ambienteve të tregjeve 5. Ngritja e ambienteve për trajtimin e mbetjeve organike 6. Ndërtimi i infrastrukturës mbështetëse. 							
b) Rezultatet që prisni							
Ndërtim i një tregu të ri të shitjes me pakicë të produkteve lokale të njësisë administrative Velipojë							
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt				
Bashkia Shkodër Ministria e bujqësisë, Azhbr Universiteti i Shkodër FSHZH			Bashkia Shkoder				
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Hartimi i projektit teknik						
A.2	Ndërtimi i tregut të shitjes Velipojë						
Shuma							

Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Hartimi i projektit teknik						
A.2	Ndërtimi i tregut të shitjes Velipojë						
	Shuma						
f) Periudha e zbatimit 2023, 2024, 2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e planifikimit strategjik dhe përmirësimit të klimës së biznesit Drejtorja e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr.18	P04130.Q2.O1.A4 Ndërtimi i tregut të shitjes me pakicë të produkteve agro-ushqimore lokale	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Nga vlerësimi i interesit dhe studimi i fizibilitetit për ndërtimin e tregjeve del e domosdoshme ndërtimi i strukturave të reja për tregtimin me pakicë të produkteve bujqësore e blegtorale. Fermerët/tregtarët të cilët shesin produktet e tyre sezonale në kushte jo të favorshme duhen mbajtur parasysh për tu zgjidhur, pasi edhe kërkesat e tyre janë të shumta për përcaktim të një vendi stabil me kushte të përshtatshme tregtimi. Në territorin e Bashkisë Shkodër qytet janë evidentuar rreth 450 fermerë/tregtarë informal që kanë nevojë për sistemim në një vend të përshtatshëm tregëtimi. Gjithashtu në Nj.A. e Bashkisë Shkodër ka kërkesë të vazhdueshme për ngritjen e një tregu për produktet vendase. Ndërtimi i Tregut Agroushqimor në qytet apo dhe në Nj.A., si një treg shumë-funksional dhe modern, i cili respekton ambientin dhe është në përputhje me standardet e sigurisë ushqimore gjithashtu rrit potencialin prodhues të sektorit bujqësor.</p> <p>Ndërtimi i tregjeve të rinj është një proces kompleks që kërkon investime kapitale të konsiderueshme. Ai duhet të mbështetet tek një studim në lidhje me kërkesat e përcaktuara qysh më parë në lidhje me ambientet dhe tek një vlerësim i plote financiar. Në kuadër të ndërhyrjeve të Bashkisë Shkodër për zhvillimin ekonomik po bëhet planifikimi për ndërtimin e një tregu të shitjes me pakicë për produkte lokale agroushqimore për të zhvilluar tregti të formave të standardizuara. Krijimi i tregjeve të formalizuara ku shërbimi dhe kontrolli nga ana e institucioneve janë më efektive, është një hap i nevojshëm që duhet ndërmarrë në mënyrë që të kemi një integrim dhe standardizim të kësaj ekonomie informale me sistemin ekonomik të Bashkisë Shkodër.</p>		
ii. Synimi i projektit		
Formalizimi i tregtimit të shitjes me pakicë në territorin e Bashkisë Shkodër dhe siguri i kushteve të përshtatshme të tregtimit nëpërmjet ngritjes së tregut sipas standardeve.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ol style="list-style-type: none"> 1. Analiza e prodhimit aktual dhe të ardhshëm të fruta-perimeve; 2. Analiza e fluksit të tregtimit të prodhimeve ekzistuese; 3. Analiza e infrastrukturës ekzistuese të tregjeve dhe evidentimi i nevojës 4. Hartimi i projektit teknik për ndërtimin e tregut të shitjes me pakicë. 5. Ndërtimi i tregut në të shitjes me pakicë 6. Mbikqyrje 7. Kolaudimi 		
b) Rezultatet që prisni		
<ol style="list-style-type: none"> 1) Ndërtimi i tregut Agroushqimor për produktet vendase 2) Rritje e sigurisë ushqimore 3) Rritje e kënaqësinë së konsumatorëve 		

c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt				
Bashkia Shkodër		Bashkia Shkodër				
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me
A.1	Projektimi					
A.2	Ndërtimi, mbikqyrja dhe kolaudimi i Tregut					
	Shuma					
f) Periudha e zbatimit 2023, 2024, 2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 19	P04130.Q3.O1.A1. Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për web sitin e turizmit.	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Një ndër instrumentat më të fuqishëm dhe më aktual të promovimit është promovimi online. Site të ndryshme web të destinacioneve turistike janë të natyrave dhe funksioneve të ndryshme. Promocioni online ofron avantazhe të shumta, është lehtësisht i arritshëm nga çdo pike e globit, mund të përditësohet shpejt, është i lirë etj. Aktualisht Bashkia Shkodër ka një website zyrtar për turizmin në Shkodër. Ky portal përmban material promocionale dhe sidomos informative, në të cilin vizitorët do të gjejnë gjithë informacionin që u nevojitet për të vizituar territorin e Shkodrës. Duke qenë se ndryshimet në turizëm janë të konsiderueshme dhe numri i turistëve po rritet çdo ditë, është i nevojshëm të bëhet përditësimi i informacioneve të faqes web për turizmin e Bashkisë Shkodër. Dëshirat dhe nevojat e turistëve janë të ndryshme dhe mjaft komplekse, prandaj kjo faqe duhet t'i përshtatet sa më shumë atyre duke dhënë informacion sa më të saktë dhe sa më cilësor, duke nxjerrë kështu në pah dhe vlerat e qytetit tonë. Shuma e kërkuar do të shpenzohet kryesisht për domainin dhe për hostingun e faqes. Gjithashtu, janë parashikuar edhe shërbime shtesë nëpërmjet krijimit të moduleve të reja në faqen web. Këto module janë parashikuar si shërbime informative shtesë për vizitorët si neësleters për aktivitete dhe të reja nga ajo që ndodh në Shkodër dhe çdo gjë tjetër që ka lidhje me eventet artistike, që mund të favorizojnë zhvillimin e turizmit në Shkodër.</p>		
ii. Synimi i projektit		
Synohet promovimi i vlerave të veçanta të destinacionit tonë turistik si dhe përmirësimi i informacionit për vizitorët.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Hostimi. • Mirëmbajtja. • Përditësim e shërbime shtesë. 		
b) Rezultatet që prisni		
Website i mirëmbajtur dedikuar turizmit të Bashkisë Shkodër.		
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt
<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoritë e ndryshme të Bashkisë (E Turizmit, e Kulturës, e Planifikimit të Territorit, Planifikimit Strategjik, e të Ardhurave etj. • Universiteti i Shkodrës • Bizneset 		<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër. • Bizneset përfituese të turizmit. • Shoqata e Artizanëve • ATA
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023	Totali	Nga kjo:

		(mijë lekë)	Paga	Siguri me	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për web sitin e turizmit.	150			150		
Shuma		150			150		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Siguri me	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për web sitin e turizmit.	500			500		
Shuma		500			500		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Siguri me	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për web sitin e turizmit.	150			150		
Shuma		150			150		
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
Janar - Dhjetor 2023 Janar - Dhjetor 2024 Janar - Dhjetor 2025		Stafi i drejtorisë së Turizmit. Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 20	P04130.Q3.O1.A2. Hostim, mirëmbajtje , përditësim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik
---------------	--	--

) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Zhvillimi i turizmit është gjithnjë e më shumë në fokusin e Bashkisë Shkodër dhe githashtu vërehet një interes gjithnjë e në rritje i turistëve të huaj dhe vendas. Një pjesë e mirë e vizitorëve të huaj vijnë në Shkodër në mënyrë të paorganizuar. Përparimet teknologjike i kanë dhënë mundësinë të gjithëve për të pasur akses më të shpejtë e më të lire në informacionin për destinacione të caktuara. Në vitin 2019 është krijuar një aplikacion për smartphone për turizmin në Shkodër. Ky aplikacion ishte i disponueshëm për shkarkim në të dyja platformat si Android ashtu IOS. Përbante informacione bazike për atraksionet e territorit të Bashkisë Shkodër si edhe një hartë orientuese për arritjen më të shpejtë të këtyre pikave të interesit. Për të ofruar një cilësi sa më të lartë shërbimi të informacionit për turistët, nevojitet që aplikacioni për smartphone të mirëmbahet dhe azhurnohet në vazhdimësi. Kjo do ndikonte mjaft në zhvillimin e mëtejshëm të turizmit në Bashkinë Shkodër. Kontrata për mirëmbajtjen e aplikacionit zgjaste deri në 2021. Me përfundimin e kontratës, aplikacioni nuk është më i disponueshëm dhe kërkohet që të ridizenjohet dhe gjithashtu të hostohet në dy platformat IOS dhe Android, për këtë arsye shuma që kërkohet është rreth 800 000 lekë sipas një vlerësimi të shërbimit që kërkohet dhe kostove të tregut për kryerjen e shërbimit.

ii. Synimi i projektit

Synohet përmirësimi dhe lehtësimi i aksesit të informacionit për vizitorët.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- Dizenjimi dhe krijimi i platformës
- Hostimi.
- Mirëmbajtja.
- Përditësim e shërbime shtese.

b) Rezultatet që prisni

Vizitorët do të kenë një instrument informacioni lehtësisht të arritshëm.

c) Aktorët e mundshëm

- Stafi i Bashkisë.(Drejtoria e Turizmit, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit, etj)
- Agjensia Kombëtare e Turizmit

d) Kontributet e mundshme në projekt

- Bashkia Shkodër.
- Bizneset përfutuese të turizmit.
- ATA

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transfere	Kapitale
A.1	Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit.	0			0		

	Shuma	0			0		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit.	100			100		
	Shuma	100			100		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit.	150			150		
	Shuma	150			150		
f) Periudha e zbatimit Janar - Dhjetor 2023, 2024, 2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së turizmit. Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 21	P04130.Q3.O1.A3. Përditësim dhe ribotim i guidës turistike të Bashkisë Shkodër.	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Zhvillimi i turizmit në zonën e Shkodrës, në vitet e fundit ka ecur me shpejtësi. Nga viti në vit, numri i turistëve dhe vizitorëve ka ardhur në rritje. Vizitorët e qytetit të Shkodrës janë kryesisht nga Evropa Perëndimore dhe Veriore, por vitet e fundit vihet re një prani e shtuar e vizitorëve nga Evropa Qendrore dhe Lindore. Gjithashtu një numër të madh të vizitorëve e përbëjnë vizitorët etnikë nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe kryesisht nga Kosova. Duke parë fluksin e këtyre turistëve dhe mbajtjen e tyre sa më gjatë në destinacionin tonë, duhet të ofrohet një guidë sa më e plotë dhe gjithpërfshirëse. Vitet e fundit, për çdo vit është bërë botimi i guidës turistike të Bashkisë në anglisht dhe shqip. Synojmë që guida të përkthehet edhe në gjuhë të tjera në varësi të vlerësimit të tregut të synuar nga ana e Bashkisë Shkodër. Me rritjen e numrit të vizitorëve dhe shtimit të interesit nga ana e turistëve të huaj për Shqipërinë dhe Shkodrën në veçanti lind edhe nevoja e shtimit të numrit të guidave turistike të printuara që do të vihen në dispozicion të tyre. Kjo arrihet nëpërmjet përditësimit, shtimit të itinerareve atraktive për turistët dhe ribotimit të saj, në mënyrë të tillë që të jetë disponibël për turistët. Për shkak të mungesës së vizitorëve në dy vitet e fundit dhe për shkak se janë printuar një seri materialesh promovionale ishin krijuar stoqe dhe vitin e kaluar nuk u riprintua. Me përmirësimin e situatës së pandemisë Covid 19, planifikojmë t'a përditësojmë me informacione të reja dhe të riprintohet.</p>		
ii. Synimi i projektit		
Më anë të këtij projekti synohet të përmirësohet dhe azhurnohet informacioni që u ofrohet vizitorëve.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ul style="list-style-type: none"> Përcaktohen termat e referencës apo specifikimet teknike për prokurimin publik që do zhvillohet. Përditësimi i informacionit dhe shtimi i itinerareve të guidës. Ribotimi i guidës. Guidat e prodhuara i vihen në dispozicion Sektorit të Marketingut dhe Shërbimit ndaj Vizitorit për t'iu ofruar vizitorëve. 		
b) Rezultatet që prisni		
Përmirësimi i cilësisë dhe sasisë së informacionit të ofruar vizitorëve nëpërmjet ribotimit të guidave turistike.		
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt
<ul style="list-style-type: none"> Stafi i Bashkisë, Drejtorja e Turizmit Deqa e Turizmit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës. Bizneset përfituese të turizmit. 		<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkodër.
e) Shpenzimet e llogaritura		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023	Totali	Nga kjo:

		(mijë lekë)	Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferim e	Kapital e
A.1	Ribotimi i guidës turistike	300			300		
Shuma		300			300		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferim e	Kapital e
A.1	Ribotimi i guidës turistike	400			400		
Shuma		400			400		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferim e	Kapital e
A.1	Ribotimi i guidës turistike	400			400		
Shuma		400			400		
f) Periudha e zbatimit Janar - Dhjetor 2023, 2024, 2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së turizmit. Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 22	P04130.Q3.O1.A4. Ribotim i hartave turistike të Bashkisë Shkodër	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:		
i. Situata		
<p>Zona e Shkodrës gjithnjë e më tepër po tërheq vizitorë nga shtete të ndryshme të botës. Këto vizitorë shpesh kanë nevojë për të marrë informacion për vendet me interes dhe mënyrën se si mund të arrihet atje. Në vitin 2018 është botuar një hartë turistike mjaft e mirë e cila përfshin të gjithë Veriun e Shqipërisë në njërën anë të saj dhe në anën tjetër paraqet në mënyrë më të detajuar të tre atraksionet turistike të territorit të Bashkisë Shkodër, që janë qyteti i Shkodrës, Velipoja dhe Thethi duke mos anashkaluar edhe pika të tjera interesante të territorit si Dajçi, anës Bunës por edhe Guri i Zi dhe lugina e Kirit. Kjo hartë jep informacion të detajuar jo vetëm për objektet e interesit po edhe informacion topografik me izohipse për të dhënë edhe një informacion shtesë për terrenin që gjendet rrugës për tek objekti i interesit. Është menduar që kjo hartë kaq e hollësishme të printohet në formate më të vogla që do të përmbajnë një nga zonat e sipërpërmendura, kjo do të bënte që vizitorët të merrnin informacion vetëm për objektet e tyre të interesit, njëkohësisht në këtë mënyrë do të reduktoheshin kostot e printimit dhe do të bëhej e mundur rritja e tirazhit të prodhimit të hartave. Por për të plotësuar nevojat e vizitorëve potencial të Bashkisë duhet të përditësohet vazhdimisht informacioni dhe të shtohet numri i kopjeve të botuara. Kjo hartë do të vihet në dispozicion të vizitorëve nga Zyra e Informacionit Turistik të Bashkisë.</p>		
ii. Synimi i projektit		
Synohet përmirësimi cilësor dhe sasior i informacionit për vizitorët.		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
<ul style="list-style-type: none"> • Përditësimi i informacionit. • Dizajnimi dhe ilustrimi. • Ribotimi i hartës. 		
b) Rezultatet që prisni		
Hartë e përditësuar për turistët.		
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt
<ul style="list-style-type: none"> • Stafi i Bashkisë. (Sektori i Marketingut dhe i Shërbimit ndaj Vizitorit, Sektori i Prokurimeve Publike, etj) • Dega e Turizmit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës. • Bizneset përfituese të turizmit. 		<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër.
e) Shpenzimet e llogaritura		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023	Totali	Nga kjo:

		(mijë lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Ribotimi i hartës	400			400		
	Shuma	400			400		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Ribotimi i hartës	400			400		
	Shuma	400			400		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Ribotimi i hartës	300			300		
	Shuma	300			300		
f) Periudha e zbatimit Janar - Dhjetor 2023, 2024, 2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së Turizmit. Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr. 23	P04130.Q3.O1.A5. Publikimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve kulturore të Bashkisë	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Eventet dhe ngjarjet kulturore janë një element atraktiv i rëndësishëm për një territor që synon të zhvillojë turizmin. Ata janë aq të rëndësishme sa shpesh janë edhe shkak i udhëtimit të vizitorëve drejt atij destinacioni. Në territorin e Bashkisë Shkodër zhvillohen mbi 80 ngjarje dhe aktivitete artistike, social-kulturore, sportive etj. Pjesa më e madhe e tyre e organizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose e mbështetur në mënyra të ndryshme nga Bashkia. Një pjesë e tyre janë aktivitete me pjesëmarrje të gjërë dhe me potencial të konsiderueshëm për të tërhequr vizitorë edhe nga treva te tjera të Shqipërisë e më gjërë. Këto vitet vitet e fundit, çdo vit është publikuar kalendar i ngjarjeve të Bashkisë Shkodër me fokus aktivitetet që mund të jenë me interes për vizitorët. Është vënë re se numri i tyre është i pamjaftueshëm për interesin në rritje të vizitorëve. Për këtë arsye duhet të përmirësohet promovimi i informacionit që lidhet me këto festa. Botimi i një kalendarit të eventeve kulturore në territorin e Bashkisë Shkodër do të kontribuonte ndjeshëm në informimin në kohë të vizitorëve potencialë. Gjithashtu informacioni i mbledhur dhe i sistemuar me këtë rast do të publikohet në faqen web të Bashkisë Shkodër dhe faqen e dedikuar për Turizmin http://visitshkodra.gov.al/. Në këtë kalendar do të promovohen edhe festat lokale, sidomos të zonave rurale për të stimuluar bizneset lokale dhe për të çuar sa më shumë vizitorë për festat tradicionale të komuniteteve të vogla dhe me më pak burime ekonomike se zonat qëndore dhe ato historikisht turistike. Për çdo festë, Bashkia do të publikojë në rrjetet sociale dhe faqen në internet të institucionit një thirrje publikut për të vizituar zonën në këto ditë të caktuara.</p>						
ii. Synimi i projektit						
Promovimi dhe përmirësimi i informacionit për ngjarjet kulturore në Bashkinë Shkodër.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Përmbledhja e informacionit për të gjitha aktivitetet që zhvillohen periodikisht në territorin e Bashkisë Shkodër. • Botimi i kalendarit. • Shpërndarja e kalendarëve. 						
b) Rezultatet që prisni						
Rritja e pjesëmarrjes në aktivitetet e organizuara nga Bashkia Shkodër si edhe përmirësimi i informacionit turistik.						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> • Stafi i Bashkisë, Drejtoria e turizmit 				<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër. • Bizneset përfituese të turizmit. 		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Botimi i kalendarit	200			200	
	Shuma	200			200	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Botimi i kalendarit	300			300	
	Shuma	300			300	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Botimi i kalendarit	200			200	
	Shuma	200			200	
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Janar – Dhjetor 2023, 2024, 2025		Stafi i Drejtorisë së Turizmit.				
		Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 24	P04130.Q3.O1.A6. Prodhimi i materialeve promociionale të tilla si dosje, stilolapsa, çanta, çakmakë etj.		Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik			
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Brandimi i një destinacioni është i mundur të bëhet në mënyrat nga më të ndryshmet. Një ndër këto mënyra është edhe dhurimi i mjeteve të përdorimit të përditshëm si çanta, stilolapsa apo magnetë. Sendë të tilla të përdorimit të përditshëm rrisin ndërgjegjësimin për një destinacion të caktuar dhe e mbajnë atë në vëmendjen e vizitorëve të mundshëm, gjithashtu shërbejnë edhe për përmirësimin e imazhit të destinacionit. Materiale të ndryshme promociionale si dosje, stilolapsa, çanta, çakmakë etj, janë materiale që kanë kosto të lire, por ndikim të madh në promovimin e një destinacioni të caktuar. Materiale të tilla janë prodhuar herë pas here dhe janë shpërndarë kyesisht në eventet e organizuara nga bashkia, por edhe delegacioneve të ndryshme që kanë vizituar Shkodrën. Për të promovuar turizmin në destinacion, janë mjaft me vlerë edhe materialet promociionale të cilët në shpërndarjen e tyre lënë një imazh të destinacionit. Është e rëndësishme që prezantimet apo takimet që do bëhen nga stafi i drejtorisë së turizmit të kenë mjetet e nevojshme identifikuese.						
ii. Synimi i projektit						
Me anë të këtij projekti synohet përmirësimi i dhe rritja e atraktivitetit të territorit të Bashkisë Shkodër.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Printimi i materialit promociional. • Materialet promociionale i vihen në dispozicion Sektorit të Marketingut dhe Shërbimit ndaj Vizitorit për t'iu ofruar vizitorëve dhe personave të tjerë të interesuar. 						
b) Rezultatet që prisni						
Promovimi i territorit të Bashkisë Shkodër si destinacion turistik.						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
<ul style="list-style-type: none"> • Stafi i Bashkisë, Drejtoria e Turizmit • Drejtoria e Kulturës • Muzeumi 			<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër. • Shoqata e artizanëve 			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Prodhim i materialeve promociionale	250			250	
	Shuma	250			250	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Prodhim i materialeve promociional	300			300	
	Shuma	300			300	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Prodhim i materialeve promociionale	300			300	
	Shuma	300			300	
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Janar - Dhjetor 2023, 2024,2025		Stafi i drejtorisë së turizmit. Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 25	P04130.Q3.O1.A7. Përgatitja dhe publikimi I itinerareve turistike	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i. Situata							
Nëse organizoni planet tuaja të udhëtimit, një itinerar turistik është një nga komponentet kyç për të qëndruar i organizuar dhe i aftë për të maksimizuar kohën e pushimeve tuaja. Veçanërisht për ata që duan të bëjnë një udhëtim vetëm, itinerari mund të shërbejë si një udhërrëfyes që përmban informacion të hollësishëm dhe themelor rreth destinacionit tuaj. Planifikimi i itinerarit duhet të bëhet me kujdes, pasi janë shumë detaje që duhet të konsiderohen siç janë; koha, ushqimi, moti, akomodimi, shëtitja etj. Si një mënyrë lehtësimi dhe organizimi për turistët që zgjedhin Shkodrën si destinacionin e tyre turistik, është menduar përgatitja dhe publikimi i disa itinerarëve turistikë që do të krijojnë shumë lehtësira dhe do të rrisin kënaqësinë gjatë qëndrimit. Këto itinerare do të konsistojnë në shënjimin e tre shtigjeve malore që mund të përdoren nga turistët potencial për hiking.							
ii. Synimi i projektit							
Promovimi i atraksioneve turistike në territorin e Bashkisë Shkodër, përmirësimi i aksesit dhe informacionit turistik.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi dhe studimi i kërkesave nga ana e turistëve • Përpunimi i informacionit. • Konceptimi dhe krijimi i itinerarëve turistik. • Publikimi i itinerareve turistike 							
b) Rezultatet që prisni							
Rritja e numrit të turistëve dhe zgjatja e kohëqendrimit të tyre në Shkodër.							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
<ul style="list-style-type: none"> • Stafi i Bashkisë • Dega e Turizmit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës. • Bizneset përfituese të turizmit. 				<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër 			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shënjim i shtigjeve turistike	220			220		
A.2	Regjistrim në sistemin GPS, dizënjim dhe publikim i fletëpalosjes	80			80		
Shuma		300			300		
f) Periudha e zbatimit Janar - Dhjetor 2022			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Stafi i drejtorisë së turizmit. Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 26	P04130.Q3.O2.A1 Panairi i artizanatit në ditën ndërkombëtare të artizanatit.	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
) Përshkrimi i shkurtër i projektit						
i. Situata						
<p>Shkodra është e njohur si në shkallë kombëtare ashtu edhe në atë ndërkombëtare për zhvillimin historik të zejeve dhe të artizanatit. Që në kohët e hershme, mjeshtrit Shkodranë janë njohur në të gjithë rajonin për sasinë dhe për punimet e rafinuara me të cilën kanë punuar mjetet e përdorimit të përditshëm. Kjo traditë është ruajtur këngshëm deri në ditët e sotme. Jo më kot edhe Shoqata e Artizanëve Shqiptarë ndodhet me seli në Shkodër. Kjo shoqatë ka edhe një marrëveshje të miratuar nga Këshilli Bashkiak i Shkodrës për organizimin e panairove periodike të artizanatit në Bashkinë Shkodër. Në një situatë në të cilën zhvillimi ekonomik dhe rritja e mirëqënies po çojnë dalëngadalë drejt humbjes së interesit për punimet artizanale dhe zbehjen e rëndësisë së tyre si aktivitet ekonomik, lind nevoja që të promovohet edhe më shumë dhe të nxitet gjithashtu edhe pjesëmarrja e të rinjve në prodhimet e produkteve artizanale. Kjo edhe për shkak të rritjes së interesit të vizitorëve dhe të turistëve të shumtë që vizitojnë qytetin për punimet artizanale dhe suvenirët. Punimet e qytetit të Shkodrës dhe të zonave përreth mbeten një suvenir i mrekullueshëm sapo viziton këtë qytet. Data 10 Qershor është shpallur nga UNESCO si Dita Ndërkombëtare e Artizanatit me qëllim ruajtjen dhe promovimin e traditës së artizanatit në mbarë botën. Për të celebruar këtë datë të rëndësishme është menduar që edhe në Shkodër të organizohet një panair gjithëpërfshirës me artizanë nga të gjitha trevat shqiptare dhe rajoni pasi panairi është një instrument i i fuqishëm që ndikon drejtpërdrejtë në promovimin e këtyre vlerave që ka Bashkia Shkodër.</p> <p><i>Procedura do të jetë sipas metodologjisë ReLoad e miratuar me Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 69, Dt.: 30.10.2017 "Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër si dhe miratimin e metodologjisë për financimin e organizatave të shoqërisë civile".</i></p>						
ii. Synimi i projektit						
Të promovojë dhe të mbështesë artizanatin në Bashkinë Shkodër.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Konceptimi i panairit në të gjithë elementët e tij. • Organizimi i aktivitetit me pjesëmarrjen e bizneseve të Shkodrës, rajonit dhe më gjërë. • Publikim i një materiali informativ me produktet që dalin nga panairi. 						
b) Rezultatet që prisni						
Rritja e interesit për prodhimin e produkteve artizanale si dhe rritja e atraktivitetit.						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> • Staf i Bashkisë • Universiteti • Shoqata të ndryshme të artizanëve 				<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër. 		
e) Shpenzimet ellogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Organizim i panairit (baner, postera, kartolina, transport, montim, qira, foni, Dj, etj).	500			500	
Shuma		500			500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Organizim i panairit (baner, postera, kartolina, transport, montim, qira, foni, Dj, etj).	500			500	
Shuma		500			500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Organizim i panairit (baner, postera, kartolina, transport, montim, qira, foni, Dj, etj).	500			500	
Shuma		500			500	
f) Periudhaezbatimit Janar - Dhjetor 2023, 2024, 2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Turizmit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr.27	P04130.Q3.O2.A2. Stenda lëvizëse "Vizito Shkodrën".	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit						
i. Situata						
Territori i bashkisë Shkodër gjithnjë e më tepër po sheh një numër në rritje të turizmit të brendshëm. një numër i madh turistësh vijnë jo vetëm nga vendet e tjera por edhe nga qytete të tjera të Shqipërisë. Edhe nga statistikat e zyrave të informacionit turistik në Shkodër, Velipojë e Theth vërehet një rritje e numrit të turistëve nga qytetet e tjera. Gjithashtu vihet re edhe një mungesë informacioni për atraksionet dhe për aktivitetet që kryhen në territorin e Bashkisë Shkodër. Gjykojmë një mënyrë e mirë për të ndërgjegjësuar turistët dhe për t'i informuar ata mbi atraksionet dhe mundësitë që ofron territori i Bashkisë Shkodër do të ishte ngritja e një stende të lëvizshme që do të vendosej në qytete të ndryshme të Shqipërisë në ditë të caktuara. Kjo stendë do të përmbante materiale promocionale për Shkodrën duke bërë në këtë mënyrë të rritet interesi i qytetarëve të atij qyteti për të vizituar Shkodrën. Bashkë me stendën do të udhëtojë edhe një pjesë e stafit të drejtorisë të cilët do të kryjnë funksionin e informacionit turistik si edhe të promovimit të qytetit.						
ii. Synimi i projektit						
Të promovojë dhe të mbështesë artizanatin në Bashkinë Shkodër.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> - Konceptimi i panairit në të gjithë elementët e tij. - Organizimi i aktivitetit me pjesëmarrjen e bizneseve të Shkodrës dhe rajonit - Promovim dhe marketing i panairit 						
b) Rezultatet që prisni						
Zhvillimi i qëndrueshëm dhe shtrirja gjithëvjetore e turizmit në territorin e Bashkisë Shkodër Diversifikimi i produktit dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve turistike						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> - Stafi i Bashkisë - Bizneset turistike - Universiteti - ATA, 				- Bashkia Shkodër.		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Pa ga	Siguri me	Operat ive	Transferi me
A.1	Konceptim, vendosje e saj ne qytete te ndryshme te Shqiperise(baner, postera, kartolina, transport, dieta, shpenzime per levizjen e personelit, etj).	300			300	
	Shuma	300			300	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Pa ga	Siguri me	Operat ive	Transferi me
A.1	Konceptim, vendosje e saj ne qytete te ndryshme te Shqiperise(baner, postera, kartolina, transport, dieta, shpenzime per levizjen e personelit, etj).	0			0	
	Shuma	0			0	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Pa ga	Siguri me	Operat ive	Transferi me
A.1	Konceptim, vendosje e saj ne qytete te ndryshme te Shqiperise(baner, postera, kartolina, transport, dieta, shpenzime per levizjen e personelit, etj).	400			400	
	Shuma	400			400	
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Janar - Dhjetor 2023, 2024, 2025		Stafi i drejtorisë së turizmit.				
		Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr.28	P04130.Q3.O2.A3 Pjesëmarrje në panair kombëtare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		
i. Situata		

<p>Zhvillimi i turizmit në zonën e Shkodrës, në vitet e fundit ka ecur me shpejtësi. Nga viti në vit, numri i turistëve dhe vizitorëve ka ardhur në rritje. Vizitorët e qytetit të Shkodrës janë kryesisht nga Evropa Perëndimore dhe Veriore, por vitet e fundit vihet re një prani e shtuar e vizitorëve nga Evropa Qendrore dhe Lindore. Gjithashtu, një numër të madh të vizitorëve e përbëjnë vizitorët etnikë nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe kryesisht nga Kosova. Gjithashtu, rajoni jonë ofron një gamë të gjërë të produkteve bujqësore dhe gastronomike me shije krejt të veçanta që përbëjnë një element shumë të rëndësishëm të ofertës turistike të rajonit. Një sinergji më e konsoliduar mes bizneseve turistike dhe atyre të produkteve bujqësore dhe gastronomike do të krijonte mundësinë për produktetë reja turistike duke rritur ndjeshëm numrin e tyre por edhe duke i përmirësuar cilësisht ato. Të gjithë këto vlera të qytetit tonë do ishte e mirë të njiheshin ndërkombëtarisht dhe pjesëmarrja në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare është një alternativë mjaft e mirë për këtë qëllim.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<p>Fundjava e javës së tretë të muajit qershor është përcaktuar si Dita e Liqenit të Shkodrës, e cila është një ditë e përbashkët e aprovuar nga të dy ministrat e Mjedisit respektive të Shqipërisë dhe Malit të Zi. Aktivitete të larmishme, për ditën e Liqenit të Shkodrës zhvillohen për çdo vit të cilët fokusohen në aktivitete promovuese social- kulturore, sportive me qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e kësaj trashëgimie të pasur natyrore të qytetit si dhe në promovimin e produkteve rajonale dhe bizneseve lokale të Shkodrës. Me anë të organizimit të këtij aktiviteti Bashkia synon të ruajë dhe të forcojë këtë traditë me qëllim tërheqjen e vizitorëve dhe ndërgjegjësimin qytetar për vlerat ekoturistike, ekonomike dhe mjedisore të liqenit të Shkodrës.</p> <p><i>Procedura do të jetë sipas metodologjise ReLoad e miratuar me Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 69, Dt.: 30.10.2017 "Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër si dhe miratimin e metodologjisë për financimin e organizatave të shoqërisë civile".</i></p>						
ii. Synimi i projektit						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Mbledhja dhe sistemimi i informacionit për materialin që do prezantohet në panaire. Prodhimi i materialeve promovionale për standin e panairit. Pjesëmarrja në panaire. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> Vizitorët që marrin pjesë në panair do të kenë një informacion më të plotë për atraksionet dhe produktet turistike të territorit të Bashkisë Shkodër. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> Stafi i Bashkisë Bizneset turistike 				<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkodër. 		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Pjesëmarrje në panair (Organizim, baner, fletëpalosje, stendë panairi, transport, qira hapësire, bileta udhëtimi, etj)	750			750	
Shuma		750			750	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Pjesëmarrje në panair (Organizim, baner, fletëpalosje, stendë panairi, transport, qira hapësire, bileta udhëtimi, etj)	300			300	
Shuma		300			300	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Pjesëmarrje në panair (Organizim, baner, fletëpalosje, stendëpanairi, transport, qirahapësire, bileta udhëtimi, etj)	700			700	
Shuma		700			700	
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Janar - Dhjetor 2023, 2024, 2025		Drejtoria e Turizmit				
		Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr.29	P04130.Q3.O3.A1. Festa e Liqenit	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit						
i. Situata						
<p>Fundjava e javës së tretë të muajit qershor është përcaktuar si Dita e Liqenit të Shkodrës, e cila është një ditë e përbashkët e aprovuar nga të dy ministrat e Mjedisit respektive të Shqipërisë dhe Malit të Zi. Aktivitete të larmishme, për ditën e Liqenit të Shkodrës zhvillohen për çdo vit të cilët fokusohen në aktivitete promovuese social- kulturore, sportive me qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e kësaj trashëgimie të pasur natyrore të qytetit si dhe në promovimin e produkteve rajonale dhe bizneseve lokale të Shkodrës. Me anë të organizimit të këtij aktiviteti Bashkia synon të ruajë dhe të forcojë këtë traditë me qëllim tërheqjen e vizitorëve dhe ndërgjegjësimin qytetar për vlerat ekoturistike, ekonomike dhe mjedisore të liqenit të Shkodrës.</p> <p><i>Procedura do të jetë sipas metodologjisë ReLoad e miratuar me Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 69, Dt.: 30.10.2017 "Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër si dhe miratimin e metodologjisë për financimin e organizatave të shoqërisë civile".</i></p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Promovimin e aktiviteteve sportive ujore në liqenin e Shkodrës si edhe vlerave të biodiversitetit të Liqenit të Shkodrës 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Në ditën e liqenit të Shkodrës janë parashikuar organizimi i një sërë aktiviteteve sportive ujore me pjesëmarrjen e sportistëve dhe veteranëve të Klubit Sportiv Vllaznia, nxënës të shkollave të mesme të qytetit, studentë të Universitetit Luigj Gurakuqi, si dhe sportistë të ftuar nga ekipe të rretheve të ndryshme të Shqipërisë. Do të zhvillohen demonstrime të sporteve ujore si edhe një program artistik. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> Promovimi i liqenit të Shkodrës si një burim ekonomik dhe turistik si edhe ndërgjegjësimi i komunitetit për vlerat e tij mjedisore dhe të biodiversitetit. 						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkoder Klubi Shumë sportësh "Vllaznia" Universiteti "Luigj Gurakuqi" 			<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkodër. 			
e) Shpenzimet ellogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ	Transferime
A.1	Zhvillim i aktivitetit (transport, foni, Dj, qira mjete lundruese, paisje për aktivitetet sportive baner, postera, lajmërimi, bluza, kapele, certifikata, etj)	450			450	
Shuma		450			450	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ	Transferime
A.1	Zhvillim i aktivitetit (transport, foni, Dj, qira mjete lundruese, paisje për aktivitetet sportive, baner, postera, lajmërimi, bluza, kapele, certifikata, etj)	450			450	
Shuma		450			450	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operativ	Transferime
A.1	Zhvillim i aktivitetit (transport, foni, Dj, qira mjete lundruese, paisje për aktivitetet sportive, baner, postera, lajmërimi, bluza, kapele, certifikata, etj)	450			450	
Shuma		450			450	
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhendjekrealizimin e projektit:				
Janar - Dhjetor 2023, 2024, 2025		Drejtoria e Turizmit				
		Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr.30	P04130.Q3.O3.A2. Dita e turizmit	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit							
i. Situata							
Zhvillimi i turizmit ka ecur me hapa të shpejtë në vitet e fundit. Numri i vizitorëve ka ardhur vazhdimisht në rritje nga viti në vit dhe po ashtu edhe shtrirja gjeografike e prejardhjes së tyre. Gradualisht sektori i turizmit po shndërrohet në një ndër sektorët lider të zhvillimit ekonomik, motor i zhvillimit ekonomik të Shkodrës. Bashkia Shkodër, duke kuptuar rëndësinë e zhvillimit të turizmit i ka dhënë përparësi të veçantë zhvillimit të tij, duke forcuar kuadrin institucional që punon në këtë drejtim. Dita Botërore e Turizmit është shpallur nga UNËTO (United Nations World Tourism Organisation) me datë 27 Shtator të vitit 1980. Që atëherë kjo datë celebron nga destinacione të vecanta me aktivitete të ndryshme sipas tematikës që përcaktohet çdo vit nga UNËTO. Gjithashtu për të ndërgjegjësuar edhe më shumë komunitetin e biznesit për të rritur përpjekjet dhe bashkëpunimin në këtë drejtim, është menduar të organizohet një festë kushtuar turizmit, pikërisht në Ditën Botërore të Turizmit me datë 27 Shtator dhe synohet që të shndërrohet në një festë tradicionale dhe të festohet çdo vit me aktivitete të ndryshme. Ky aktivitet do të evidentojë dhe do të promovojë mëtej edhe vlerat dhe potencialet e veçanta turistike që ka territori i Bashkisë Shkodër. Për sivejt është parashikuar që në ditën ndërkombëtare të turizmit të zhvillohet një seancë trajnimi 2 ditore për rritjen e kapaciteteve të bizneseve turistike. Në këtë trajnim do angazhohen 2 ekspertë për							
ii. Synimi i projektit							
Promovimi i vlerave dhe potencialeve turistike në territorin e Bashkisë Shkodër.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ul style="list-style-type: none"> • Panair (didaktik, i shërbimeve, atraksioneve, produkteve, etj) • Publikim i materialeve promociionale. 							
b) Rezultatet që prisni							
Rritja e numrit të turistëve dhe zgjatja e sezonit turistik.							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër • Bizneset përfituese të turizmit. • ATA • Shkolla e Mesme Profesionale Teknologjike, dega Hoteleri Turizëm 				<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër. 			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A1.	Organizimi i aktivitetit me temën e vitit nga UNËTO. (lajmërime, botime promociionale për festën, panair, etj)	250			250		
Shuma		250			250		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Organizimi i aktivitetit me temën e vitit nga UNËTO. (lajmërime, botime promociionale për festën, panair, etj)	300			300		
Shuma		300			300		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Organizimi i aktivitetit me temën e vitit nga UNËTO. (lajmërime, botime promociionale për festën, panair, etj)	0			0		
Shuma		0			0		
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
Shtator 2023, 2024, 2025		Drejtoria e Turizmit					
		Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr.31	P04130.Q3.O3.A3. Hapja e sezonit turistik Velipojë	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit						
i. Situata						
<p>Velipoja është një ndër destinacionet më të njohura të bregdetit Shqiptar me vlera të padiskutueshme dhe potenciale të konsiderueshme për zhvillimin e turizmit të diellit e rërës. Aktualisht frekuentohet nga një numër i madh pushuesish gjatë sezonit të verës të përqëndruar kryesisht vetëm në muajt korrik e gusht, por Velipoja zotëron potenciale të tilla që ky sezon të jetë më masiv dhe më i shtrirë në kohë. Dita e hapjes së sezonit turistik është zhvilluar çdo vit këto vitet e fundit me pjesëmarrjen e banorëve të zonës dhe qytetarë nga Shkodra. Aktiviteti është mjaft kompleks dhe me shumë elementë ku përfshihen koncerte nga grupe të rinjsh nga Shkodra dhe qytete të tjera, demonstrime të sporteve që lidhen me detin por jo vetëm si psh kayaking, kanoying, beachvolley, handball etj. Organizimi i kësaj feste kontribuon ndjeshëm në përmirësimin e promovimit që i bëhet Velipojës dhe kështu ndikon drejtpërdrejt në rritjen e numrit të vizitorëve dhe pushuesve në Velipojë.</p> <p><i>Procedura do të jetë sipas metodologjise ReLoad e miratuar me Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 69, Dt.:30.10.2017 "Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër si dhe miratimin e metodologjisë për financimin e organizatave të shoqërisë civile".</i></p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Promovimi i vlerave natyrore turistike të plazhit të Velipojës 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Program artistik. Aktivitete sportive në rërë. Publikim i materialeve promovionale. 						
b) Rezultatet që prisni						
Promovimi i burimeve dhe atraksioneve turistike të Velipojës nëpërmjet organizimit të Ditës së Hapjes së Sezonit turistik						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkodër Bizneset përfituese të turizmit. Universiteti i Shkodrës, Fakulteti i Turizmit. 				<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkodër. 		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Organizimi i aktivitetit (Baner, postera, koncert, foni, Dj, etj).	450			450	
Shuma		450			450	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Organizimi i aktivitetit (Baner, postera, koncert, foni, Dj, etj).	450			450	
Shuma		450			450	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Organizimi i aktivitetit (Baner, postera, koncert, foni, Dj, etj).	500			500	
Shuma		500			500	
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Janar - Dhjetor 2022, 2023, 2024		Drejtoria e Turizmit				
		Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr.32	P04130.Q3.O3.A4. Festa e Thethit	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit							
i. Situata							
Zona e Thethit është një nga destinacionet më atraktive të territorit të Bashkisë Shkodër e më gjërë. i gjendur në zemër të Alpeve ofron mundësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e shumë llojeve të turizmit malor dhe të aventurës Hapja e sezonit turistik në Theth do të shoqërohet me organizimin e “ Festës së Thethit”, një festë e kthyer tashmë në traditë. Kjo festë është konceptuar në mënyrë të tillë që të përmbajë sa më shumë elementë të traditës lokale dhe të promovojë në mënyrë sa më gjithë përfshirëse atraksionet e vecanta të një destinacioni të jashtëzakonshëm. Duke qënë se territori i Thethit është edhe Park Kombëtar me rëndësi të jashtëzakonshme për florën e faunën shqiptare synohet jo vetëm promovimi i vlerave dhe bukurive të vecanta që ka ai por njëkohësisht edhe ndërgjegjësimi për ruajtjen e tij nga ndikimi potencial që mund të ketë zhvillimi i turizmit. <i>Procedura do të jetë sipas metodologjisë ReLoad e miratuar me Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 69, Dt. 30.10.2017 “Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër si dhe miratimin e metodologjisë për financimin e organizatave të shoqërisë civile”.</i>							
ii. Synimi i projektit							
<ul style="list-style-type: none"> Promovimi i vlerave natyrore turistike të fshatit Theth. 							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ul style="list-style-type: none"> Organizimi i Festës me të gjithë komponentët e saj; Lajmerime dhe botime promovionale për festën Program artistik Shpenzime logjistike epër ngritjen dhe funksionimin e panairit Pjesmarrja e operatorëve turistik vendas dhe të rajonit, rrjetin e hotelesisë dhe restoranteve të Thethit. 							
b) Rezultatet që prisni							
Promovimi i burimeve dhe atraksioneve turistike të Thethit nëpërmjet organizimit të Ditës së Hapjes së Sezonit turistik							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkodër Bizneset përfituese të turizmit. Universiteti i Shkodrës, Fakulteti i Turizmit. 				<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkodër. 			
e) Shpenzimet ellogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Organizimi i aktivitetit (Postera, baner, bluza, kapele, fletëpalosje, program artistik me artistë të zonës, transport, foni, Dj, etj)	500				500	
Shuma		500				500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Organizimi i aktivitetit (Postera, baner, bluza, kapele, fletëpalosje, program artistik me artistë të zonës, transport, foni, Dj, etj)	500				500	
Shuma		500				500	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Organizimi i aktivitetit (Postera, baner, bluza, kapele, fletëpalosje, program artistik me artistë të zonës, transport, foni, Dj, etj)	500				500	
Shuma		500				500	
f) Periudhaezbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:					
Janar - Dhjetor 2023, 2024, 2025		Drejtoria e Turizmit					
		Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					

Nr.33	P04130.Q3.O3.A5. Dita e biçikletave	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit						
i. Situata						
<p>Shkodra është qyteti numër një në Shqipëri për përdorimin e biçikletës me një traditë të hershme të përdorimit të saj, që zë fill që në shekullin e XIX. Gjithashtu, Shkodra renditet në 10 qytetet që përdorin më shumë biçikletën në shkallë europiane. Gjatë periudhës së dikaturës biçikleta ishte mjete kryesor i transportit në Shkodër, pasi numri i makinave ishte shumë i kufizuar. Me ardhjen e demokracisë dhe zhvillimin ekonomik numri i makinave ka ardhur vazhdimisht në rritje duke kërcënuar kështu zbehjen e kësaj tradite. Gjithashtu, rritja e numrit të makinave rrezikon edhe ndotjen e ajrit nga gazrat dhe elementëve të tjerë të mjedisit nga mbetjet e tyre. Me organizimin e ditës së biçikletave dhe shndërrimin e saj në një festë të përvitshme synohet ripërtëritja e traditës, si edhe promovimi i mënyrës së shëndetshme të jetesës por synohet edhe gjallërimi i jetës kulturore të qytetit duke rritur atraktivitetin etj.</p> <p><i>Procedura do të jetë sipas metodologjise ReLoad e miratuar me Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 69, Dt.:30.10.2017 "Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër si dhe miratimin e metodologjisë për financimin e organizatave të shoqërisë civile".</i></p>						
ii. Synimi i projektit						
Promovimi i përdorimit të biçikletës dhe gjallërimi i jetës social-kulturore të Shkodrës.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Aktivitete të ndryshme me fokus biçikleten • Xhiro demonstrative m ebicikleta • Ekspozitë / konkurs fotografie • Publikim i materialeve promocionale për përdorimin e biçikletës 						
b) Rezultatet që prisni						
Realizimi i kësaj feste do të risën dërgjegjësimin qytetar për përdorimin e biçikletës dhe do të krijojë një atmosferë festive në qytet.						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> • BashkiaShkoder • DAR • Klubi Shumësportësh Vllaznia 				<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër. 		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Organizimi i aktivitetit. (Printime të certifikatave, bluzave, baner, kartolina, postera, transport materialesh, qira për biçikleta, foni, Dj, ndriçim,etj)	350			350	
Shuma		350			350	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Organizimi i aktivitetit. (Printime të certifikatave, bluzave,baner, kartolina, postera, transport materialesh, qira për biçikleta, foni, Dj,	350			350	
Shuma		350			350	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Organizimi i aktivitetit. (Printime të certifikatave, bluzave, baner, kartolina, postera, transport materialesh, qira për biçikleta, foni, Dj, ndriçim,etj)	350			350	
Shuma		350			350	
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Janar - Dhjetor 2023, 2024, 2025		Drejtoria e Turizmit				
		Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 34	P04130.Q3.O3.A6. Triathlon	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Triathlon është një garë multidisiplinore sportive me origjinë të hershme, por në epokën moderne, e ka zanafillën në vitin 1974, në San Diego të Californisë, USA. Është një aktivitet që përveç rezultateve sportive synon dhe promovon jetën e shëndetshme dhe socializimin në mes të atletëve. Bashkia Shkodër, në kuadër të zhvillimit të sportit dhe turizmit në liqenin e Shkodrës, organizon aktivitetin e përvitshëm "Triathlon Labeat" – një kompeticion tre garësh: not, çiklizëm dhe vrapim. Qëllimi i këtij aktiviteti është promovimi dhe nxitja e zhvillimit të sportit, si një mënyrë e shëndetshme e të jetuarit. Aktiviteti karakterizohet nga pjesmarrja e gjerë e sportistëve dhe amatorëve të sportit nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, rajonit dhe Europës. Aktivitete të tilla shërbejnë në promovimin e turizmit natyror në liqenin e Shkodrës, si një aset i pazëvendësueshëm i territorit dhe kontribuon në promovimin e burimeve dhe potencialeve që zotëron Liqeni i Shkodrës për zhvillimin e sporteve ujore dhe turizmit në tërësi.						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Të nxisë zhvillimin e aktiviteteve sportive ujore. • Të ndërgjegjësojë komunitetin për ruajtjen e mjedisit dhe pasurive ujore si Liqeni i Shkodrës. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për realizimin e aktivitetit; • Zhvillimi i tre-garëshit: not-vrapim dhe çiklizëm. • Shpallja e fituesve dhe ndarja e çmimeve. 						
b) Rezultatet që prisi						
<ul style="list-style-type: none"> • Ndërgjegjësim i rritur përvlerat sportive turistikedhemjedisore tëliqenit të Shkodrës. 						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër. • DAR • Klubi Shumësportësh Vllaznia 				<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër • Shoqatat Sportive 		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
				Sigurim e	Operativ e	Transferi me
A.1	Organizimi dhe zhvillimi i aktivitetit. (banera,postera, bluza, çertifikata, qira, transport, foni, Dj, moderator etj)	400			400	
	Shuma	400			400	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me
A.1	Organizimi dhe zhvillimi i aktivitetit. (banera,postera, bluza, çertifikata, qira, transport, foni, Dj, moderator etj)	400			400	
	Shuma	400			400	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me
A.1	Organizimi dhe zhvillimi i aktivitetit. (banera,postera, bluza, çertifikata, qira, transport, foni, Dj, moderator etj)	400			400	
	Shuma	400			400	
f) Periudha e zbatimit			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:			
Janar - Dhjetor 2023, 2024, 2025			Stafi i Drejtorisë së Turizmit			
			Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër			

Nr. 35	P04130.Q3.O3.A7. Mbështetje për Panairin e Ornitologjisë	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Ornitologjia është fusha shkencore e dedikuar për studimin dhe mbarështimin e zogjve. Shkodra është e njohur për traditën e saj të vecantë në rritjen dhe mbarështimin e zogjve të kafazit. Ne vitin 2017, ne Shkodrë, u organizua për herë të parë, "Panairi i Ornitologjisë" me iniciativën e Federatës Shqiptare të Ornitologjisë (FOSH). Ne këtë panair kishte pjesmarrës nga e gjithë Shqipëria, Kosova, Mali Zi, Maqedonia dhe Italia. Duke parë që ky festival solli një numër të madh të personave që janë të interesuar në mbarështimin e zogjve, mendojmë që këto aktivitete t'a mbështesim në vazhdimësi në mënyrë që të krijohet një traditë e suksesshme në Shkodër, sepse edhe Shkodra është e njohur për një numër të madh ornitologesh (mbarështues zogjsh).						
ii. Synimi i projektit						
– Rritja e atraktivitetit të territorit të Bashkisë Shkodër nëpërmjet rritjes së numrit të aktiviteteve me interes për vizitorët.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
– Konceptimi i panairit në të gjithë elementët e tij.						
– Organizimi i aktivitetit me pjesëmarrjen e ornitologeve.						
b) Rezultatet që prisni						
• Rikthimi i traditës së Ornitologjisë në qytetin e Shkodrës						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
– Stafi i Bashkisë Shkodër			– Bashkia			
– FOSH			– FOSH			
– Bizneset përfituese të turizmit.						
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Zhvillimi i panairit (transport, qira, publikime, katering, etj)	300		300		
Shuma		300		300		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Zhvillimi i panairit (transport, qira, publikime, katering, etj)	300		300		
Shuma		300		300		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Zhvillimi i panairit (transport, qira, publikime, katering, etj)	0		0		
Shuma		0		0		
f) Periudha e zbatimit		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:				
Janar - Dhjetor 2023, 2024, 2025		Stafi i Drejtorisë së Turizmit				
		Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				

Nr. 36	P04130.Q3.O3.A8. Lojra Popullore Fest	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>“Lojra Popullore Fest” është një aktivitet me karakter social-kulturor për të rinjtë i cili synon jo vetëm të pasurojë jetën e të rinjve por edhe ti njohë ata me traditat tona kombëtare me anën këngëve, valleve dhe lojrave popullore. Qëllimi i aktivitetit është promovojë paqen, tolerancën, miqësinë në mes të trupave pjesëmarrëse. “Lojra popullore fest” gjithashtu synon që të pasurojë jetën e të rinjve duke i angazhuar ato në identifikimin e vlerave njerëzore e vlerave folklorike e kombëtare e ndërkombëtare. Vetë të rinjtë konkurojnë me performanca me lojra popullore, këngë e valle të traditave kombëtare dhe enografike. Projekti nxit rininë për promovimin e vlerave turistike. Ky aktivitet është kthyer në traditë për qytetin e Shkodrës. Këtë vit do ketë pjesëmarrje të fëmijëve nga gjithë territori i bashkisë. Ky aktivitet do realizohet në amfiteatrin natyror Ana e Malit, Oblikë, në fermën eko sociale. <i>Procedura do të jetë sipas metodologjisë ReLoad e miratuar me Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.: 69, Dt. 30.10.2017 “Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër si dhe miratimin e metodologjisë për financimin e organizatave të shoqërisë civile”.</i></p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> - Të pasurojë jetën social kulturore të të rinjve. - Të promovojë dhe t'i njohë ata me traditat e njesive administrative të Bashkisë Shkodër dhe me tej me anë të performimeve të këngëve, valleve dhe lojrave popullore. - Të përfshijë të gjithë njesive administrative të Bashkisë së Shkodrës, nëpërmjet përfaqësimit nga të rinjtë e këtyre njesive. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> - Përzgjedhja e trupave kandidate për pjesëmarrje - Ngritja e bashkëpunimit me trupat e përzgjedhura - Përgatitja e ambientit ku do zhvillohet aktiviteti: skena, sigurimi i nevojave bazë. <p><i>Procedura për zhvillimin e aktivitetit, do bëhet me thirrje publike, ku komisioni artistik do gjykojë projektin më të mirë.</i></p>						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> - Promovimi i vlerave dhe traditave kulturore të njesive administrative të Bashkisë së Shkodrës dhe angazhimi i të rinjve përmes një pjesëmarrjeje të gjerë 						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
<ul style="list-style-type: none"> - Staf i Bashkisë Shkodër (Drejtoria e Turizmit; Drejtoria e Shërbimeve Sociale); - Komuniteti - Institucione publike 			<ul style="list-style-type: none"> - Bashkia Shkodër - DAR - OJF 			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2023		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Organizimi i aktivitetit.	350			350	
	Shuma	350			350	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Organizimi i aktivitetit.	300			350	
	Shuma	300			350	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Organizimi i aktivitetit.	350			350	
	Shuma	350			350	
f) Periudha e zbatimit			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:			

Janar - Dhjetor 2023, 2024, 2025	Stafi i Drejtorisë së Turizmit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër
----------------------------------	--

Nr. 37	P04130.Q4.O1.A1. Rrjeti i Zyrave të informacionit turistik Qyteti Shkodër, Velipojë, Theth	Funksioni 4: Çështje ekonomike Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Në situatën aktuale të zhvillimit të turizmit ku territori i Bashkisë Shkodër, vizitohet nga një numër i madh vizitorësh të huaj, një pjesë e të cilëve vijnë në mënyrë të vetëorganizuar dhe pa e njohur territorin. Në këtë kuadër informacioni turistik merr një rëndësi të veçantë, pasi i shërben orientimit të këtyre vizitorëve duke i njohur ata me atraksionet e territorit të Shkodrës, mënyrën më të mirë për të arritur, informacione për cilësinë e shërbimeve të ndryshme etj. Bashkia Shkodër disponon dy zyra të informacionit turistik në qytetin e Shkodrës dhe në plazhin e Velipojës. Ato janë konstruksione pjesërisht druri dhe pjesërisht mur dhe një pjesë e madhe e sipërfaqes së tyre përbëhet nga vetrata e xhamit. Si konstruksione të tilla, ata kanë një normë të lartë amortizimi si edhe vetratat e mëdha prej xhami nuk sigurojnë izolim termik në objekt duke e bërë mjaft të vështirë qëndrimin dhe shërbimin në këto zyra. Prandaj, kemi gjykuar që të bëhen punime riparuese dhe të zëvendësohen vetratat e xhamit me vetrata me dopio xham që do të sigurojnë kushte më të mira pune për personelin dhe rrjedhimisht edhe përmirësim të performancës së zyrës. Këtë vit planifikojmë të kryejmë ndërhyrje riparuese në zyrën e informacionit turistik në Velipojë.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> Përmirësimi i shërbimit në zyrat e informacionit turistik në Shkodër dhe Velipojë . 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ol style="list-style-type: none"> Identifikimi i nevojave për ndërhyrje dhe hartim i dokumentacionit tekniko- ligjor. Zhvillimi i prokurimit publik. Kryerja e punimeve dhe marrja në dorëzim e objektit. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> Përmirësimi i shërbimit në ZIT në Shkodër dhe Velipojë. 						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt			
<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkodër. Bizneset e shërbimeve turistike 			<ul style="list-style-type: none"> Bashkia Shkodër 			
e) Shpenzimet e llogaritura (pika iii)						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Punime rikonstruksioni (zbatim)	180				180
A.2	Blerje pajisje	120				120
	Shuma	300				300
f) Periudha e zbatimit			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:			
Janar - Dhjetor 2025			Stafi i Drejtorisë së Turizmit			
			Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër			